

Thirrja nga data 18.04.2024 deri në datën 25.04.2024

## TERMAT E REFERENCES

### PËR

### TRAJNER/E PËR OFRIMIN E TRAJNIMIT “ORIENTIMI DHE KËSHILLIMI NË KARRIERË”

<b>Organizata</b>	<b>OJQ “NEVO KONCEPTI</b>
<b>Objektiva</b>	<b>Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimit në temën “Orientimi dhe këshillimi në karrierë” për anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) në Prizren.</b>

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

## 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

”Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

*Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 nxënës të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.*

## 2. OBJEKTIVA

Orientimi dhe këshillimi në karrierë është një aftësi e vlefshme jetësore që gjithkush ka nevojë për të pasur sukses. Edhe nëse keni aftësi për të bërë diçka. Fëmijët mund ti përgadisim për, aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore dhe karrierën e tyre të ardhshme, duke i mësuar atyre menaxhimin efikas të kohës. Ndhimojini fëmijët të vendosin qëllimet e qarta që mund t'i ndihmojnë ata të arrijnë detyra specifike, prandaj Nevo Koncepti po kërkon një trajner/e për të ofruar dhe zhvilluar trajnimin një ditorë për fëmijët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Prizren mbi temën ‘Orientimi dhe këshillimi në karrierë’ i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve tek fëmijët, për orientimin në karrierë dhe këshillimin për të. Trajnimi do të mbahet me antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, grup moshë e fëmijëve 12 – 15 vjeçar/e.

### 1. Kualifikimi i kandidatit/ës

Trajneri/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

Diplomë Master në fushën e Psikologjisë dhe Shkencave të tjera shoqërore.

- 5-7 vjet përvojë pune si trajner/e, duke përfshirë hartimin moduleve të trajnimit dhe ofrimin e programeve
- Shkathtësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e trajnimit.
- Të jetë i/e aftë në komunikim me fëmijët, t'i mësoj dhe këshillojë fëmijët mbi temën Orientimi dhe këshillimi në karrierë
- Udhëheqë trajnimin me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse në pajtim me 9 rregullat për pjesëmarrje të sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve: <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/nine-basic-requirements-meaningful-and-ethical-childrens-participation/>
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)

**Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.**

### 3. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me 26 Prill deri me 17 Maj 2024. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të trajnimit	Zhvillimi / adaptimi i programit të trajnimit, përfshirë matrialet e trajnimit, si dhe të formojë vlerësimin Pre Post Test për Orientimi dhe këshillimi në karrierë.	2	Prill 2024
2	Ofrimi i programit të trajnimit për Asamblenë Komunale të Fëmijëve	Ofrimi i trajnimit 1-ditor për një grup të pjesëmarrësve	1	Prill 2024
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimit i raportit përfundimtar mbi angazhimin në trajnimin Orientimi dhe këshillimi në karrierë.	1	Prill 2024
	<b>Gjithsej:</b>		<b>4</b>	

### 4. REZULTATET E PRITSHME

- AKF të jetë e njohur me termet kryesore që ndërlidhen me “Orientimi dhe këshillimi në karrierë”
- AKF të përfitojë njohuri si të bëjë zgjedhje të mirëinformuar në lidhje me të mësuarit dhe mundësitë e karrierës, të kuptojnë se si këto zgjedhje do t’u ndihmojnë atyre për ti plotësuar aspiratat e tyre, për të vlerësuar arritjet, interesimet dhe prirjet e tyre gjithashtu për të avokuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Trajneri/ja, duhet të ketë parasyshtë që edhe shembujt të cilët merren për antaret e Asamblesë gjatë trajnimit të kenë lidhje me avokimin dhe ngritjen e kapaciteteve si avokues.

### PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t’i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së trajnimit.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 25.04.2024** në [e.qylangji@nevokoncepti.org](mailto:e.qylangji@nevokoncepti.org) duke e kopjuar (cc) në email [o.osmani@nevokonepti.org](mailto:o.osmani@nevokonepti.org)